



KOLEGJI AAB – PRISHTINË
Programi Komunikim Masiv dhe Gazetari (MA)

Dekanatit

Programi për Studimet: Master

Emri i programit të Masterit: Komunikimi Masiv dhe Gazetaria.

Lënda: Kërkesë për lejimin e punimit të diplomës, tezat dhe projekt temën e masterit

Kandidati: Mimoza Bajraktari nga Klina

Titulli i Temës: "Gazeta Rilindja 1980-1990"

Propozimi për mentor: Dr.Sc. Bujar Tafa

Përshkrimi i shkurtër i temës:

"Rilindja" ka funksionuar në kushte specifike politike ku shumëçka e shkruar ka qenë e censuruar, përjashtuar disa periudha të vonshme në vitet 80. Pavarësisht kësaj, "Rilindja" ishte e përditshmja e vetme në gjuhën shqipe në Kosovë. Në këtë drejtim, qëllimi është të analizohen një spektër çështjesh që lidhen me frymën e funksionimit të "Rilindjes" si media, apo edhe çështje që kanë pasur ndikim në mënyrën se si ajo ka plasuar informacionet.

Një nga arsyet kryesore, gjë që shërben si motivim për këtë studim, qëndron në faktin se duke trajtuar funksionimin e "Rilindjes", gjatë një periudhe dhjetëvjeçare (1980-1990), trajtohen njëkohësisht edhe segmente të shumta të jetës shoqërore, politike dhe ekonomike në përgjithësi tek shqiptarët në federatën e dikurshme jugosllave, gjithnjë duke u përpjekur të dallohen momentet në të cilat plasimi i informacionit ka qenë i censuruar politikisht.

Prishtinë, 04.04.2015

Nënshkrimi i kandidatit
Mimoza Bajraktari